



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr. 2844/23 Datë: 30.12.2023

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT – PRIZREN

Raport i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren për vitin 2023

Në këtë raport janë pasqyruar aktivitetet, projektet dhe punët e kryera në DKA në periudhën janar – dhjetor 2023.

Drejtorja Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik për periudhën janar– dhjetor për vitin 2023, bazuar në planifikimin e sektorëve në DKA mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar dhe realizuar aktivitete dhe projekte të ndryshme.

Në këtë raport përfshihen punët administrative, monitorimi dhe mbikqyrja e shkollave, rekomandime për shkollat, përgjigjet e vendimeve për transferimin e nxënësve të shkollave mesme të larta, procedurat e ndërtimit të objekteve shkollore, anekseve, riparimeve, mirëmbajtjen e objekteve dhe

ambienteve shkollore, projektet që lidhen me sigurinë në shkolla, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve, etj.

Raporti për periudhën janar – dhjetor për vitin 2023 është përpiluar nga raportet e aktiviteteve, projekteve të realizuara dhe punëve të tjera të kryera nga DKA gjatë kësaj periudhe. Në këtë raport janë përmbledhur të dhënat e sektorit të arsimit, administratës e financave, aktivitetet dhe punëtoritë e zhvilluara në vitin 2023.

Luljeta Veselaj Gutaj

Drejtoreshë e DKA-së në Prizren

Tel. 03820035321

E-mail: Luljeta.Veselaj@rks-gov.net



Hyrje

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik të saj për periudhën janar – dhjetor 2023, dhe bazuar në planifikimin e sektorëve në DKA mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar dhe realizuar aktivitete e projekte të ndryshme.

1. Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave - Udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës.

-Përgjatë vitit 2023 janë përzgjedhur udhëheqësit e shkollave (drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e shkollave), ndërsa janë në proces të përzgjedhjes vetëm dy drejtorë të shkollave.

-Në prill 2023 është aprovuar “Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore në Komunën e Prizrenit”, me çka është lehtësuar qeverisja dhe menaxhimi i shkollave si dhe puna e edukatorëve dhe mësimeve.

-Është aprovuar dokumenti për “Zonat e Mbulimit në shkollat e Komunës së Prizrenit sipas nivelit 1 dhe 2 të standardeve ndërkombëtare të klasifikimit të arsimit (ISCED)”.

-Është hartuar plani për digjitalizimin e sistemit të arsimit në DKA në formën e projektit, aktualisht në fazën e prokurimit të shërbimeve.

-Ka filluar procesi për hartimin e “planit zhvillimor të arsimit në komunë”. Ky proces është në fazën e realizimit të shërbimeve planifikuese.

2. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja - Bashkëpunim cilësor dhe efikas ndërmjet hisedarëve të edukimit parashkollor

-Ka nisur procesi i identifikimit të institucioneve parashkollore private. Janë mbajtur disa takime koordinuese me Inspektoratin e Arsimit, ku janë duke u koordinuar vizitat dhe mbledhja e të dhënave.

-Bashkë me agjencitë zhvillimore është duke vazhduar përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta. DKA ka negociuar me 'Caritas Kosova' për të vazhduar marrëveshjen për dhënie të shërbimeve profesionale psikologjike për fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu vazhdon bashkëpunimi edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare (Unicef, SCIK etj) për të përmirësuar shërbimet arsimore për nxënësit në nevojë.

-Është duke vazhduar procesi i funksionalizimit të institucionit të edukimit të hershëm në lagjen "Bajram Curr". Në këtë institucion pa përfunduar përzgjedhja e udhëheqësit, është bërë planifikimi buxhetor, është përzgjedhur personeli, dhe është kryer përgatitja për hapjen solemne në tremujorin e parë të vitit 2024.

-Ka përfunduar thirrja për arsimin joformal, po vazhdon faza e organizimit dhe angazhimit të personelit për fillimin e arsimit joformal.

-Përmes garave dhe aktiviteteve të tjera ndërkulturore, është duke u promovuar multikulturalizmi dhe diversiteti në arsimin parauniversitar.

3. Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve - Zhvillim i vazhdueshëm i kapaciteteve për mësimitdhënie cilësore

-Bashkë me shkollat janë duke u identifikuar nevojat për zhvillimin profesional të personelit arsimor. Shkollat janë duke organizuar trajnime profesionale me buxhetin e tyre, ndërsa përmes organizatave të tjera janë duke u organizuar trajnime në fushat deficitare si mësimitdhënia e digjitalizuar etj.

- SBASHK në vitin 2023 ka bërë trajnimin e mbi 500 mësimitdhënësve.

-Janë identifikuar mbi 82 mësimitdhënës të pensionuar gjatë periudhës mars 2022- mars 2023, të cilëve iu janë dhënë meritat dhe mirënjohjet për zhvillimin e cilësisë në arsim dhe përkushtimin jetësor dedikuar arsimit.

4. Zbatimi i kurrikulës së re - Ndërtim i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe i mekanizmave për zbatim dhe monitorim të kurrikulës së re

-Është intensifikuar shërbimi i këshillëdhënies për shkollat lidhur me zbatimin e KKK. Përmes drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë shkollat marrin këshilla nga DKA për modalitetet e zbatimit të KKK, për sfidat e zbatimit dhe për zgjidhjet e mundshme të problemeve *ad-hoc* të zbatimit të KKK. Gjithashtu shkollat vazhdimisht furnizohen me materiale pune, me udhërrëfyes dhe dokumentacion të domosdoshëm për zbatimin e KKK.

5. Sigurimi i cilësisë - Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkolla

-Vazhdon përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë. Përmes MASHT dhe agjencive zhvillimore koordinatorët e cilësisë me bazë në shkollë marrin trajnime relevante dhe ndërtojnë kapacitetet për zbatim të KKK dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies në shkollat e komunës.

Meqenëse është duke u shtuar përdorimi i mjeteve digjitale në funksion të mësimdhënies dhe nxënies, 40 shkolla janë furnizuar me tabela 'smart' si dhe është bërë grumbullimi i kërkesave të shkollave për furnizim me pajisje teknologjike.

-Me bashkëfinancim me IOM disa shkolla do të pajisen me kabinete fizike, kimie, biologjie dhe gjeografie bazuar në nevojat e shkollave.

-Për vitin shkollor 2022-2023 Drejtoria Komunale e Arsimit ka dhënë 50 bursa. Nga 100 bursa sa ishte vitin e kaluar numri ka shkuar në 150. Po ashtu është rritur dhe vlera e bursës me 200 euro. Nga 500 euro është rritur në 700 euro.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndarë 35 bursa nga 300 euro për nxënës të shkollave të mesme për fëmijët e invalidëve të luftës si dhe për 12 nxënës me nevoja të veçanta. Për 17 nxënës udhëtarë është rritur numri i bursave si dhe është shtuar vlera e bursës nga 200 euro në vitin 2022 këtë vit është bërë 300 euro.

I. Të dhënat statistikore

Në fillim të vitit shkollor 2023/2024 në institucionet publike të menaxhuara nga Komuna e Prizrenit mësimin e ndjekin 24351 nxënës të 58 shkolla të menaxhuara nga DKA-së, përfshirë edhe çerdhen publike. Në tabelarin e mëposhtëm janë të dhënat e numrit të nxënësve të komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2023/24.

Numri i nxënësve në institucionet publike të komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2023 – 2024													
Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Niveli i mesëm i lartë		
Parashkollorë	Parafillorë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
172	1571	2066	2003	2022	2144	2053	2190	2035	2057	2092	1329	1342	1275
Gjithsej													
Në nivelin e edukimit të hershëm												1743	
Në nivelin fillor												10288	
Në nivelin e mesëm të ulët												8374	
Në nivelin e mesëm të lartë												3946	
Për të gjitha nivelet												24351	

Struktura e të punësuarëve në arsim

Nr.	KUADRI	SHQIP		BOSHNJAK		TURQ		RAE		GJITHSEJ		GJITHS EJ
		M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
1	EDUKATOR	1	67		9		6		3	1	85	86
2	MËSUES (I-V)	101	397	52	22	1	32	1	1	155	452	607
3	ARSIMTAR (VI-IX)	361	334	80	30	15	21			456	385	841
4	MËSIMDHËNËS (X-XII)	162	112	19	13	11	13			192	138	330
5	DREJTOR	34	18	6	1					40	19	59
6	ZV.DREJTOR	3	2			3				6	2	8
7	SEKRETAR	11	10							11	10	21
8	PSIKOLOG	1	7							1	7	8
9	PEDAGOG	5	2							5	2	7
10	BIBLIOTEKIST	5	6							5	6	11
11	STAF MBËSHTETES	193	21	22	11	5	5	13	19	233	56	289
	TOTALI	877	976	179	86	35	77	14	23	110 5	1162	2267

Arsimi i komuniteteve

Drejtorët e shkollave të komuniteteve dhe shkollave në të cilat zhvillohet mësimi edhe në gjuhët e komuniteteve përkatëse, raportojnë në DKA në mënyrë periodike për sfidat dhe ecurinë e procesit edukativo - arsimor. Një ndër sfidat kryesore në shkollat ku zhvillohet mësimi në gjuhët e komuniteteve është furnizimi me tekste shkollore nga MASHTI. Mungesa e teksteve shkakton vështirësi në procesin mësimor për nxënësit e komuniteteve. Shkollat janë udhëzuar të përdorin burime alternative.

Tabela e numrit të nxënësve sipas përkatësisë etnike:

Numri i nxënësve sipas komuniteteve në Komunën e Prizrenit 2023 - 2024														
Etnia	Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Niveli i mesëm i lartë		
	Parashkollorë	Parafillore	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
	Shqiptarë	136	1312	1732	1710	1743	1810	1740	1860	1731	1698	1774	1107	1120
Boshnjakë	7	90	134	125	110	144	143	146	159	169	129	102	113	89
Turq	11	105	123	96	103	116	88	112	85	118	132	120	109	63
Rom, ashkali, egjiptian	1	47	77	72	66	74	82	72	60	72	57	7	17	10

Gjithsej në nivelin e edukimit të hershëm	Shqiptarë	Boshnjakë	Turq	Rom, ashkali, egjiptian
	1448	97	116	48
Gjithsej në nivelin fillor	Shqiptarë	Boshnjakë	Turq	Rom, ashkali, egjiptian
	8735	656	526	371
Gjithsej në nivelin e mesëm të ulët	Shqiptarë	Boshnjakë	Turq	Rom, ashkali, egjiptian
	7063	603	447	261
Gjithsej në nivelin e mesëm të lartë	Shqiptarë	Boshnjakë	Turq	Rom, ashkali, egjiptian
	335	304	292	34

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

DKA ka shtuar numrin e psikologëve në shkolla, dhe asistentëve për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta. Janë trajnuar mësuesit dhe asistentët për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta për çështje që lidhen me gjithëpërfshirje. Në bashkëpunim me organizata të ndryshme janë krijuar qendra mësimore për fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe është shtuar numri i mësuesve mbështetës. Në bashkëpunim me organizatat vendore dhe ndërkombëtare janë krijuar dhe zbatuar programe dhe projekte në fushën e arsimit, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta.

DKA ka themeluar dhe funksionalizuar komisionin për vlerësim të fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe ka krijuar databazën me të dhëna, ku pasqyrohen në mënyrë të hollësishme llojet dhe shkalla e dëmtimeve. Brenda vitit 2023 ekipi vlerësues ka kryer vlerësimin sipas UA të MASHTI-t të 34 fëmijëve, ndërsa punohet me plane individuale të arsimit me 254 fëmijë.

Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Gjithsej
Parashkollor	Parafillor	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	
n/a	11	17	21	26	39	17	27	36	26	33	254

Gjithpërfshirja

Në bashkëpunim me MASHTI-n dhe OJQ-të e ndryshme janë mbajtur punëtori dhe trajnime sensibilizuese dhe edukuese me temë të gjithpërfshirjes. Kërkohet më shumë angazhim nga prindërit e tyre, institucionet lokale, qendrore dhe nga OJQ-të. Çështja e vijueshmërisë është duke u trajtuar për fëmijët në rrugë edhe më tej, më shumë vëmendje për të përmirësuar çështjen e gjithpërfshirjes.

Sfidat:

- Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësimit në lidhje me arsimin gjithpërfshirës;
- Trajnimi i mësimit, mësimit mbështetës dhe asistentëve të angazhuar në klasat ku ka nxënës të komuniteteve;
- Zgjerimi i njohurive të mësimit rreth praktikave moderne në fushën e arsimit gjithpërfshirës;
- Braktisja e nxënësve vazhdon të jetë sfidë. Kjo vjen si pasojë e gjendjes së rënduar ekonomike të familjeve të nxënësve të komuniteteve;
- Indiferenca e prindërve të nxënësve të komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptas;
- Çështja e vijueshmërisë duhet të trajtohet edhe më tej edhe pse situata është përmirësuar në krahasim me vitet e mëparshme.

Standardet në arsim - Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Përmes formularëve të vlerësimit të kapaciteteve të DKA-së për sektorin e arsimit janë përshkruar trajnimet e mësimitdhënësve:

- Trajnimi i 84 edukatorëve të institucioneve shkollore të komunës së Prizrenit, në kuadër të projektit “Shpresë”, është realizuar në bashkëpunim me Caritasin zviceran. Përmes këtij projekti edukatorët kanë rritur aftësitë dhe kapacitetet e tyre në planifikimin dhe zbatimin e orës mësimore përmes lojës; gjithëpërfshirjes; të menduarit kritik dhe kreativ;
- Angazhimi i dy moderatorëve/ndërmjetësve shkollore nga komuniteti rom. Ky projekt është financuar nga BE dhe është implementuar nga OJQ “Nevo Koncepti”;
- Në bashkëpunim me “Teach for Kosova” është angazhuar një moderator/ndërmjetës në shkollën “Motrat Qiriazit” dhe “Hysen Rexhepi”;
- Trajnimi i drejtuesve të shkollave dhe mësimitdhënësve me temë “Shkathtësitë bazë dhe zhvillimi i lidershipit”. Ky projekt është realizuar në bashkëpunim me British Council;
- Trajnimi i 71 mësimitdhënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta me temë “Përkrahja psiko-sociale dhe të nxënësve emocional” me mësimitdhënës. Ky projekt është realizuar në bashkëpunim me organizatën ‘Save the Children’;
- Trajnimi i mësimitdhënësve me temë "Edukimi seksual dhe riprodhues". Ky trajnim është kryer në bashkëpunim me IP i Kosovës dhe përfaqësues të MASHTI;
- Databazë e trajnimeve të mësimitdhënësve. Në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik të Kosovës është realizuar një hulumtim me temë: “Nevojat për Zhvillim Profesional të Mësimitdhënësve në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët”. Përmes kësaj databaze janë identifikuar nevojat për ZHP të mësimitdhënësve.
- Janë trajnuar 150 arsimtarë të gjuhës angleze në bashkëpunim me Korpusin e Paqes në Kosovë, “Bëjeni mësimin e nxënësve real dhe efektiv!”. Ky trajnimi ka eksploruar teoritë dhe praktikën e mësimitdhënies dhe të nxënësve të bazuar në kompetenca, me qëllim të mbështetjes të zbatimit të Kurrikulës së Kosovës.

Qeverisja e arsimit në komunë – Struktura menaxheriale

Në dhjetë vitet e fundit arsimit në Kosovë ka qenë sfidë në vete. DKA nga ky vit ka nisur procesin e riorganizimit si njësi menaxheriale e arsimit në komunë. Dinamizimi i arsimit ka nxjerrë nevojën për riorganizim dhe ristrukturim të DKA-së për t'iu përgjigjur ndryshimeve në sektorin e arsimit. Bazuar në organogramën e re, janë caktuar detyrat dhe përgjegjësitë të punonjësve të DKA-së.

Shërbimi ligjor në DKA

Zyra ligjore në DKA për periudhën janar - dhjetor 2023 ka ndihmuar komunitetin arsimor, prindërit dhe nxënësit me një sërë shërbimesh ligjore, përmes ndihmës juridike.

Llojet e shërbimeve:

- 299 vendime për pushime të lehonisë, pushime pa pagesë, ndërprerje të marrëdhënies së punës me vetëdëshirë, përfundimi i kontratës së punës, punëtorët arsimorë në pension, punëtorët arsimorë që ndërrojnë jetë, pagat percjellëse me rastin e daljes në pension, formime të komisioneve, pranime teknike, etj;
- 186 përgjigje me shkrim palëve të ndryshme;
- 189 pëlqime për studentë;
- Pëlqime për OJQ, në lidhje me implementimet e projekteve nëpër shkolla;
- 5164 lëndë janë përcjellë në zyrën e përfaqësimit ligjor në Komunën e Prizrenit, që kanë të bëjnë me përfaqësimin e DKA-së në gjykatë, lëndë për përgjigje në padi zakonisht për paga jubilarë, pagesat e shujtave, kompensimin e kualifikimit për licencë dhe kompensimin e inflacionit për punëtorët arsimorë;
- Vizita në disa institucione shkollore lidhur me zbatimin e masave anti covid-19, si dhe rekomandime shkollore për çështje administrative dhe ligjore;
- 2 ankesa në inspektoriatin e MASHTI;

- 2 rekomandime;
- 17 vërtetime;
- 3 kërkesa;
- 13 njoftime;
- 4 referenca;
- Memorandume të bashkëpunimit;
- Rregullore për institucionet arsimore në komunën e Prizrenit;
- Komisioni për ankesa dhe parashtesa në komunën e Prizrenit;
- Komisioni disiplinor ka kryer 12 raste dhe për të njëjtit ka marrë vendime;
- Përpilimi i konkurseve për mësimdhënës dhe punëtorë teknikë;
- 14 vendime të punës për drejtorë dhe 1 zv.drejtor;
- 23 kontrata për drejtorë dhe zv.drejtorë;
- Konsulta me drejtorët e shkollave, mësimdhënës, nxënës, prindër dhe palë të tjera;
- Opinione ligjore në ministritë përkatëse;
- Angazhim në rregullimin e arkivës së DKA;

Menaxhimi i financave


- Në fillim të vitit 2023 është kryer plani i zotimeve dhe nënalokimeve, pasqyra e ndarjes së buxhetit të shkollave për kategorinë e pagave dhe shërbimeve komunale të cilat i janë dërguar shkollave. DKA në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave është përgatitur për fillimin e vitit të ri fiskal me udhëzimet që rrjedhin nga thesari.
- Janë realizuar zotimet e mjeteve për kategoritë ekonomike sipas kërkesave të shkollave. Deri në përmbyllje të vitit fiskal 2023 janë zotuar **1721** lëndë, për të gjitha kategoritë shpenzuese si dhe janë përgatitur raporte periodike sipas nevojës për institucionet shkollore, përkatësisht janë njoftuar shkollat për buxhetin e alokuar dhe shpenzimet sipas kërkesave të tyre.
- Janë përpunuar ndryshimet në listat e pagave për periudhën janar- dhjetor ku janë procesuar kërkesat e shkollave sipas pasqyrës së mëposhtme, ku në bazë të këtyre të dhënave sektori i financave për këtë periudhë ka proceduar gjithsej **2865** lëndë.

Pasqyrë e procesimit të lëndëve për periudhë janar – dhjetor në kategorinë e pagave						
Muaj	Punëtor ë të rinj	Pagesa retroaktiv e /ore jashtë orarit	Ndryshim e	Transfer e bankare	Largime nga lista	Ndale sa në pagë
Janar	17	202	41	6	10	
Shkurt	1	243	34	5	6	14
Mars	47	255	48	5	8	1
Prill	15	200	33	4	14	1

Maj	1	205	34	4	12	1
Qershor	39	184	24	7	9	1
Korrik	14	302	30	1	18	1
Gusht	4	104	28	4	5	0
Shtator	10	32	28	4	12	8
tetor	32	12	53	4	11	1
ntor	16	131	41	3	10	1
dhjetor	46	125	28	4	10	1
Gjithsej	242	1995	422	51	125	30

- Në bazë të raportit përmblledhës të shpenzimeve për paga të institucioneve shkollore për periudhën 1 vjeçare janë bërë pagesa me vendime gjyqësore me vlerë 743.026€ në kategorinë e pagave të arsimit fillor në kuadër të kompensimit të shujtave për mësimdhënësit. Këto ekzekutime kanë vazhduar të dëmtojnë buxhetin e arsimit. Pagesa me vendime gjyqësore ka pasur edhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve me vlerë 50.000 euro.
- Në kuadër të angazhimit të sektorit të financave në bashkëpunim me zyrtarin kryesor financiar, DKA iu është përgjigjur kërkesave të auditorit në lidhje me pagesat me vendime gjyqësore të vitit të kaluar.
- Ka vazhduar bashkëpunimi me zyrtarë të departamentit të buxhetit lidhur me të dhënat e kërkuara për stafin aktual dhe janë përcjellur pasqyra me të dhënat e kërkuara.
- Me përfundimin e vitit fiskal sektori i financave ka analizuar gjendjen mbi ecurinë e shpenzimeve në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm përkatësisht realizimin e buxhetit dhe ka përgatitur pasqyren e shpenzimeve ku janë paraqitur të dhënat e shkollave për realizimin e buxhetit sipas planifikimit.
- Shpenzimet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve nga **granti qeveritar** janë realizuar mbi 99 % sipas tabelës dhe grafikut të poshtëshënuar:

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Shpenzimet	Zotim /Obligimet në pritje	Mjete te pa shpenzuar	% e shpenzimeve
ADMINISTRATA - PRIZREN	838,254.00	823,718.04	14,476.12	59.84	98.3
ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET	52,720.00	52,685.35	10.65	24.00	99.9
ARSIMI FILLOR	775,085.00	765,459.85	9,618.70	6.45	98.8
ARSIMI I MESËM	180,672.00	178,391.79	2,272.26	7.95	98.7
TE HYRAT VETANAKE, ADMINSITRATRA E DKA-SE	55,500.00	54,742.51	719.60	37.89	98.6
TE HYRAT VETANAKE, ÇERDHET	360,000.00	348,491.38	11,493.62	15.00	96.8
TE HYRAT VETANAKE, ARSIMI I MESËM	40,000.00	37,325.07	2,659.93	15.00	93.3
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	160,000.00	149,363.67	10,625.80	10.53	93.4



- Në **arsimim parafillor** janë shpenzuar 52685.35 euro ose 99.9% të mjeteve të ndara buxhetore
- Në **arsimin fillor** janë shpenzuar 765.459.85 euro ose 98.8% ndërsa pjesa prej 9618.7 euro apo 1.8 % kane mbetur të pashpenzuara deri në fund të këtij viti fiskal
- Në **arsimin e mesëm** 178.391.79 euro apo 98.7 % është shpenzuar, ndërsa pjesa tjetër 2.272.26 euro apo 3 % janë ende të pashpenzuara.
- Gjithashtu Drejtoria e Arsimit ka pasur në dispozicion të hyra vetanake për 2023-shin dhe të hyra të bartura të vitit 2022 cilat janë shpenzuar mbi .93 %.
- Për të pasur një pasqyrë më të detajuar të shpenzimeve sipas të gjitha kategorive dhe burimeve, bashkangjitur keni raportin përmbledhës të buxhetit për periudhën janar – dhjetor, të hartuar në datë. 28.12.2023.

Pasqyrë e shpenzimeve të buxhetit 28.12.2023

Përshkrimi	Buxheti Aktual	E paalokuar	Shpenzimet	Zotim /Obligimet në pritje	Mjete te Lira
622 PRIZREN	22.696,996.96	1.246,346.5 1	20.127,282.76	33.077.88	2.536,636.32
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	950,365.28	0.00	925,984.75	14,476.12	9,904.41
111 PAGA DHE SHTESA	112,111.28	0.00	102,266.71	0.00	9,844.57
ADMINISTRATA -DKA	838,254.00	0.00	823,718.04	14,476.12	59.84
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET- PRIZREN	418,145.31	0.00	388,030.71	565.87	29,548.73
111 PAGA DHE SHTESA	179,919.31	0.00	150,672.91	0.00	29,246.40
ARRSMI PARAFILLOR MALLRA DHE SHËRBIME	52,720.00	0.00	52,685.35	10.65	24.00
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	18,201,350.12	1,186,425.5 1	15,852,694.55	13,707.00	2,334,948.57
111 PAGA DHE SHTESA	15,742,630.12	1,184,425.5 1	13,416,037.94	0.00	2,326,592.18
130 MALLRA DHE SHËRBIME	775,085.00	0.00	765,459.85	9,618.70	6.45
132 SHPENZIME KOMUNALE	131,130.00	2,000.00	129,129.36	1,592.61	408.03
300 PASURITË JOFINANCIARE	1,552,505.00	0.00	1,542,067.40	2,495.69	7,941.91

94470 ARSIMI I MESËM - PRIZREN	3,127,136.25	59,921.00	2,960,572.75	4,328.89	162,234.61
111 PAGA DHE SHTESA	2,883,100.25	59,921.00	2,721,010.80	0.00	162,089.45
130 MALLRA DHE SHËRBIME	180,672.00	0.00	178,391.79	2,272.26	7.95
132 SHPENZIME KOMUNALE	63,364.00	0.00	61,170.16	2,056.63	137.21
21 TE HYRAT VETANAKE	909,995.00	0.00	723,919.91	25,973.20	160,101.89
622 PRIZREN	909,995.00	0.00	723,919.91	25,973.20	160,101.89
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	55,500.00	0.00	54,742.51	719.60	37.89
130 MALLRA DHE SHËRBIME	55,500.00	0.00	54,742.51	719.60	37.89
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET- PRIZREN	360,000.00	0.00	281,762.38	11,493.62	66,744.00
130 MALLRA DHE SHËRBIME	360,000.00	0.00	348,491.38	11,493.62	15.00
500 TË HYRAT JO-TATIMORE	0.00	0.00	-66,729.00	0.00	66,729.00
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	334,495.00	0.00	323,394.95	11,100.05	0.00
INVESTIMET KAPITALE	334,495.00	0.00	323,394.95	11,100.05	0.00
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZREN	160,000.00	0.00	64,020.07	2,659.93	93,320.00
111 PAGA DHE SHTESA	70,000.00	0.00	46,673.00	0.00	23,327.00

130 MALLRA DHE SHËRBIME	40,000.00	0.00	37,325.07	2,659.93	15.00
INVESTIMET KAPITALE	50,000.00	0.00	50,000.00	0.00	0.00
500 TË HYRAT JO-TATIMORE	0.00	0.00	-69,978.00	0.00	69,978.00
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	449,379.19	0.00	411,478.89	12,171.38	25,728.92
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	427,622.53	0.00	398,478.89	12,171.38	16,972.26
130 MALLRA DHE SHËRBIME	160,000.00	0.00	149,363.67	10,625.80	10.53
INVESTIMET KAPITALE	267,622.53	0.00	249,115.22	1,545.58	16,961.73
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZREN	21,756.66	0.00	13,000.00	0.00	8,756.66
111 PAGA DHE SHTESA	21,756.66	0.00	13,000.00	0.00	8,756.66

Në raportin përmbledhës është e dukshme rritja e shpenzimeve, përkatësisht për qindja e realizimit të shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të DKA-së në raport me periudhën e njëte të vitit të kaluar, si dhe rritja e shpenzimeve për paga për shkak të fillimit të implementimit të ligjit të pagave nga muaji shkurt. Në pasqyrën e mësipërme nga thesari nuk janë paraqitur pagat e muajit dhjetor si realizim me vlerë 1.445.220 euro

II. Aktivitetet në periudhën janar – dhjetor 2023

Krahas aktiviteteve me nxënës të cilat i organizojnë shkollat, DKA ka organizuar gara dhe aktivitete të ndryshme me nxënës me qëllim të arritjes së mobilizimit më të madh, për rritje të cilësisë në arsim, të gjithpërfshirjes dhe të dinamizimit në jetën shkollore.

I. Procesi mësimor në shkollat e mesme të larta në Komunën e Prizrenit

Drejtoria Komunale e Arsimit nën menaxhim ka pesë (5) shkolla të mesme të larta:

1. Gjimnazi i Shkencave të Natyrës “Gjon Buzuku”,
2. Gjimnazi Shoqëror-Gjuhësor “Remzi Ademaj”,
3. Shkolla e mjekësisë SHMLM “Luciano Motroni”,
4. Shkolla ekonomiko-juridike IAAP “Ymer Prizreni”
5. Shkolla e muzikës SHMLM “Lorenc Antoni”.

Në pesë (5) shkollat e mesme të larta janë të përzgjedhur stafi menaxherial me drejtorë dhe zëvendës/drejtorë të shkollave, dhe të gjitha strukturat tjera janë funksionale si: Këshillat e Prindërve, Këshilli Drejtues i Shkollave, Ekipet e EPRBM, Këshillat e Arsimtarëve dhe Nxënësve, etj. Shkollat në bashkëpunim me Aktivet Profesionale kryejnë detyrat përkatëse, për mbarëvajtje më të mirë të procesit mësimor. Janë monitoruar dhe rekomanduar shkollat sipas të gjeturave.

Në fillimin e gjysmëvjektorit të dytë të vitit shkollor 2022/2023 në institucionet publike të menaxhuara nga Komuna e Prizrenit, në shkollat e mesme të larta e ndjekin mësimin 4188 nxënës (si në tabelar), dhe numri i të punësuarëve në shkollat e mesme të larta është 397, prej tyre 350 janë mësimdhënës të të gjitha fushave, staf udhëheqës dhe sekretarë janë 8, psikologë dhe pedagogë shkollorë janë 4, dhe staf mbështetës/punëtorë ndihmës janë 35.

Në Komunën e Prizrenit ka edhe shkolla tjera të mesme të cilat janë në menaxhimin e MASHTI-t, (Agjension): Qendra e Kompetencës dhe shkolla e teknikës QK “11 Marsi”, Medreseja “Alaudin” si dhe kolegjet private: Gymnazium “Loyola”, College Mehmet Akif, International Maarif School dhe shkolla (çerdhe) të tjera private. Në Komunën e Prizrenit janë edhe dy qendra burimore për fëmijë me nevoja të veçanta, që janë nën menaxhimin e MASHTI-t, si: Q.B. “Nënë Tereza” dhe Q.B. “Lef Nosi” në Prizren.

Mësimi në shkollat e mesme të larta

- Në Gjmnazin e shkencave të natyrës “Gjon Buzuku” nxënësit ndjekin mësimet në të tri gjuhë: shqip, atë boshnjake dhe turqisht. Gjmnazi “Gjon Buzuku” ka profilet e shkencave natyrore. Shkolla ka edhe paralelet e ndara në Gjonaj, Romaj dhe në Reçane.
- Në Gjmnazin e shkencave shoqërore “Remzi Ademaj” nxënësit ndjekin mësimet vetëm në gjuhën shqipe. Gjmnazi shoqëror-gjuhësor ka paralelet e ndara në Gjonaj, Romaj, Zym, Zhur dhe në Velezhë.
- Shkolla e mesme e mjekësisë “Luciano Motroni” ka profilet shëndetësore, dhe nxënësit e ndjekin mësimin në tri gjuhë, shqipe, boshnjake dhe turke. Shkolla nuk ka paralele të ndara.
- Shkolla e mesme ekonomiko-juridike “Ymer Prizreni” ka profilet ekonomike, juridike dhe të agrobiznesit. Nxënësit e ndjekin mësimin në tri gjuhë, shqipe, boshnjake dhe turke. Shkolla ka paralele të ndara edhe në Gjonaj e në Romajë.
- Shkolla e mesme e muzikës “Lorenc Antoni” ka profilet e muzikës dhe të baletit. Nxënësit e ndjekin mësimin vetëm në gjuhë shqipe. Shkolla nuk ka paralele të ndara.

Statistikat e numrit të nxënësve dhe struktura e të punësuarëve në SHML:

Numri i nxënësve në institucionet publike të komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2022 – 2023											
Numri i nxënësve në klasën e dhjetë (X)			Numri i nxënësve në klasën e njëmbëdhjetë (XI)			Numri i nxënësve në klasën e dymbëdhjetë (XII)			Gjithsej nxënës në arsimin e mesëm të lartë		
Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
549	877	1426	577	828	1405	507	850	1357	1633	2555	4188
Të punësuarit në shkollat e mesme të larta											
Kuari								Shqip	Boshnj	Turk	Gjithsej
Mësimdhënës në listë të pagave (X-XII)								294	33	23	350
Drejtorë dhe zëvendës/drejtorë në SHML								6	-	-	6
Sekretar								2	-	-	2
Psikolog dhe pedagog shkollor								4	-	-	4
Staf mbështetës/Punëtor teknik								34	1	-	35
GJITHSEJ								340	34	23	397

Tabelari: Të dhënat janë marrë nga zyrtari i statistikave në DKA prej sistemit SMIA

Monitorimi dhe rekomandimet në shkollat e mesme të larta

Në gjysmëvjetorin e parë janë monitoruar shkollat e mesme si në regjistrimin e nxënësve në klasë të dhjetë (X), dhe mbarëvajtja e procesit mësimor.

Janë dhënë rekomandime për shkollat e mesme të larta për të rritur bashkëpunimin me KDSH, këshillin e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve; si dhe janë sugjeruar shkollat për të marrë masa adekuate për të ulur numrin mungesave të nxënësve dhe mësimdhënësve, për të ngritur cilësinë në mësimdhënie e mësimnxënie duke zbatuar ligjet e arsimit parauniversitar dhe UA të MASHTI-t.

Drejtoritë e shkollave të mesme të larta janë rekomanduar që:

1. Me KDSH të bëjnë rishikimin e Planit Zhvillimor të Shkollës – PZSH (të përpilojnë PZSH të ri sipas plankoncepteve të drejtorëve të zgjedhur me konkurs) dhe të raportojnë planifikimin dhe shpenzimet e buxhetit të shkollës dhe masat që do të nxjerrin nga nevojat e ndryshme të shkollave në realizimin e ndonjë nga objektivat e pritshme të shkollës, lidhur edhe me arritjen e rezultatetve të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
2. Të bashkëpunojnë dhe të realizojnë takime të përmuajshme (çdo dy muaj është e detyrueshme) me të gjitha aktivet profesionale për fushat e kurrikulës apo me aktivet e drejtimeve profesionale të shkollës, për arritjen e rezultateve dhe realizimin e planprogrameve, si dhe evidentimin apo realizimin e instrumenteve të vlerësimit;
3. Të monitorojnë dhe kontrollojnë vazhdimisht realizimin e planprogrameve vjetore, dymujore, dhe përgatitjet ditore të mësimdhënësve duke mbajtur evidencë në një databazë (tabelar) publike për mësimdhënësit në tabelarin e njoftimeve, dhe të përcjellin vazhdimisht ditarët personal të mësimdhënësve për vlerësimin e nxënësve sipas instrumenteve të paracaktuara nga aktivet profesionale, bazuar në UA 06/2022;
4. Të diskutojnë me Këshillin e Prindërve, Këshillin e Klasës dhe Nxënësve lidhur me mungesat e shumta dhe me masat që duhet të merren në bazë të UA të MASHTI 6/2014.

Statistikat e suksesit të nxënësve janë duke u plotësuar nga shkollat në sistemin SMIA, dhe kanë afat deri më datë 10.02.2023, kur këto statistika do të analizohen nga shkollat së bashku me aktivet profesionale në realizimin e rezultateve të lëndës, fushës kurrikulare dhe rezultatet e të nxënit për fushën kurrikulare.

Me rezultatet e shkollave për gjysmëvjetorin e parë do të njoftoheni nga zyrtari Fisnik Berisha i cili është duke grumbulluar statistikat e shkollave dhe rezultatet e nxënësve për gjysmëvjetorin e parë.

II. Vizita në shkolla tjera të Komunës së Prizrenit

Sipas planit të shefit të sektorit të arsimit, përveç shkollave të mesme të larta janë monitoruar edhe disa shkolla fillore të mesme të ulëta, sipas pikave që janë kërkuar si në vijim:

- Pajisja e nxënësve me tekste mësimore.
- Libri i regjistrimit të nxënësve në klasë të parë dhe parafillor, dhe klasë të dhjetë,
- Planet vjetore të punës së drejtorëve të shkollave.
- Kontrollimi i orarit të ndjekjes ditore dhe javore të mësuesve.
- Pika të tjera që mund të vendosen në koordinim me drejtoreshën e DKA-së dhe që këto apo edhe ato më lart duhet të vendosen në vendimin për vizitë.
- Procesverbalet e Këshillit Drejtues i Shkollës, Këshilli i arsimtarëve, Plani vjetor i shkollës, PZSHH, procesverbalet e aktiveve profesionale,
- Planprogramet mësimore të mësimdhënësve (Planet vjetore, dymujore, javore dhe ditore).
- Orari mësimor i shkollës, aktivitetet jashtë kurrikulare, kujdestaria e ditës në shkollë
- Ekipet e EPRBM të shkollës, Këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve,

- Zhvillimi Profesional i mësimdhënësve,
- Niveli i pastërtisë në shkollë dhe ambientet e shkollës
- Numri i nxënësve sipas paraleleve, numri i mësimdhënësve etj.
- Vijueshmëria e procesit mësimor.

Shkollat janë monitoruar edhe në aktivitete të ndryshme jashtëkurrikulare.

- SHFMU “Sinan Thaqi” në Zojz,
- SHFMU “Luigj Gurakuqi” në Nashec;
- SHFMU “Krusha e Vogël” në Krushe të Vogël;
- Cerdhja në Lagjen Bajram Curri në Prizren;
- ShFMU “Ibrahim Fehmiu” në Prizren;
- ShFMU “Gani Saramati” në Prizren;
- ShFMU “Dy Dëshmorët” në Piranë;
- SHFMU “Brigada 125” në Medvec;
- ShFMU “Vëllezërit Frashëri” në Planejë;
- ShFMU “Zef Lush Marku” në Velezhë;
- ShFMU “Izvor” në Lubinje të Epërme;
- ShFMU “25 Maji” në Lubinje të Poshtme;
- ShFMU “Pllanjanë” në Pllanjanë;
- ShFMU “Mati Logoreci” në Prizren për zëvendës/drejtor;
- SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren për zëvendës/drejtor.

III. Garat Komunale dhe Republikane të Fizikanit të Ri 2023

Duke u bazuar në UA të (MASHTI) nr. 04/2022 për organizimin dhe mbajtjen e garave të Fizikanit të Ri me nxënës **të klasëve të 9-ta, 10-ta, 11-ta dhe 12-ta** në nivel të shkollës, komunës, dhe garave në nivel ndërkombëtar, Shoqata e Fizikanëve të Kosovës në bashkëpunim me MASHTI-n dhe DKA më datë **11 shkurt 2023** janë organizuar garat shkollore dhe komunale, ku edhe janë zgjedhur nxënësit fitues nga Komuna e Prizrenit për në garat e XIV Republikane të Fizikanit të Ri 2023.

Në Garat Republikane të Fizikanit Ri, këtë vit kemi nxënës fitues në garat shtetërore nga Komuna e Prizrenit. Nxënësi i klasës 11-të Skender Krasniqi nga gjimnazi “Gjon Buzuku” me vendin e parë në garat republikane të fizikës, nxënësi i klasës së 12-të Andi Mala nga Kolegji Mehmet Akif me vendin e dytë në garat republikane të fizikës, nxënësit e klasës së 10-të Vis Gashi nga gjimnazi “Gjon Buzuku” dhe Malsor Arifi nga Kolegji Mehmet Akif, me vendin e tretë në garat republikane të fizikës.

Nxënësit fitues në garat republikane dhe garat komunale janë shpërblyer me mirënjohje dhe me dhurata modeste nga Drejtoria Komunale e Arsimit.

Fituesit në Garat Komunale të Fizikanëve të Rinj 2023						
Nr	Emri	Mbiemri	Klasa	Shkolla	Vendi	Fituesi
1	Erëza	Gacaferri	9	Emin Duraku	Prizren	Vendi I-rë
2	Erëza	Gashi	9	Hysen Rexhepi	Prizren	Vendi II-të

3	Maksut	Arifi	10	Mehmet Akif	Prizren	Vendi I-rë
4	Vis	Gashi	10	Gjon Buzuku	Prizren	Vendi II-të
6	Olgerta	Qenaj	10	Gjon Buzuku	Prizren	Vendi II-të
6	Fjolla	Jakupi	11	Mehmet Akif	Prizren	Vendi I-rë
7	Besjon	Bobaj	11	Remzi Ademaj	Prizren	Vendi II-të
8	Skender	Krasniqi	11	Gjon Buzuku	Prizren	Vendi II-të
9	Benjamin	Kryeziu	12	Gjon Buzuku	Prizren	Vendi I-rë
10	Leoart	Shala	12	Mehmet Akif	Prizren	Vendi II-të

IV. Garat Komunale të Olimpiadës së Matematikës për vitin 2023

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren ka organizuar garat shkollore, dhe ka përgatitur listat e nxënësve fitues të klasëve 7-ta, 8-ta, 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe të 12-ta. Garat Komunale të Olimpiadës së Matematikës me nxënës të klasëve 7-ta, 8-ta, 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe të 12-ta janë mbajtur më 25 nëntor 2023, në SH.F. “Abdyl Frashëri” në Prizren.

Garat Shtetërore të Olimpiadës së Matematikës (OMK) u mbajtën më 23 dhjetor 2023 në Prishtinë, në lokalet e Gjimnazit të Specializuar Matematikor. DKA siguroi transportin e nxënësve për në garat shtetërore të OMK.

Nga Olimpiada Matematike e Kosovës do përzgjidhet ekipi prej 6 nxënësve fitues të garave shtetërore që do të përfaqësojë shtetin e Kosovës në Olimpiadën e 65-të Matematike Ndërkombëtare - IMO 2024, e cila do të mbahet në Bath, në Mbretërinë e Bashkuar prej datës 10.07.2024 deri

më datën 13.07.2024, ku Kosova merr pjesë për herë të katërmbëdhjetë në cilësinë e anëtarit me të drejta të plota. Gjithashtu, nga Olimpiada Matematike e Kosovës përzgjidhet ekipi fitues prej katër vajzave që do të përfaqësojnë shtetin e Kosovës në Olimpiadën e 13-të Europiane të Matematikës për Vajza - EGMO 2024, e cila do të mbahet në qytetin Tskaltubo, në Gjeorgji, prej datës 11.04.2024 deri më datën 19.04.2024.

Po ashtu, nga Olimpiada Matematike e Kosovës do të përzgjidhen nxënësit nga klasat, VII, VIII dhe IX që do të përfaqësojnë shtetin e Kosovës në Olimpiadën e 5-të mbarëkombëtare Kosovë - Shqipëri, e cila do të mbahet në muajin korrik në vitin 2024.

NXËNËSIT FITUES NË GARAT KOMUNALE TË OLIMPIADËS SË MATEMATIKËS

Në Garat Komunale të Olimpiadës së Matematikës që u mbajtën më datë 25.11.2023 kanë marrë pjesë 209 nxënës të klasëve: VII-ta, VIII-ta, IX-ta, IX-ta, X-ta, XI-ta dhe XII-ta prej 244 nxënësve nga 39 shkollat e Komunës së Prizrenit. Në gara kanë marrë pjesë nxënës edhe të komunitetit boshnjak dhe turk.

Lista dhe rezultatet e nxënësve në Garat Komunale në Olimpiadën e Matematikës:				
Vendi	Emri dhe mbiemri	Klasa	Shkolla	Renditja
1	Muhamad Thaqi	Klasa 7	Shmu "Hysen Rexhepi"	Vendi parë (I)
2	Nisanur Muçeziu		Shfmu "Motrat Qirazi"	Vendi dytë (II)
3	Lies Velija		Shfmu "Mushnikova"	Vendi tretë (III)
1	Arjonë Zogaj	Klasa 8	College "Mehmet Akif"	Vendi parë (I)
2	Daris Hodza		Shmu "Gani Saramati"	Vendi dytë (II)
3	Rexhep Shatri		Shfmu "Hysni Temaj"	Vendi tretë (III)
1	Rumejsa Smaili	Klasa 9	Shfmu "Mushnikova"	Vendi parë (I)
2	Lum Demiri		Shfmu "Motrat Qirazi"	Vendi dytë (II)

3	Vigan Sylejmani		Shfmu "Motrat Qiriazhi"	Vendi tretë (III)
1	Rigon Hajdaraj	Klasa 10	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	Vendi parë (I)
2	Leart Muhaxheri		Gjimnazi "Gjon Buzuku"	Vendi dytë (II)
3	Ilir Krasniqi		College "Mehmet Akif"	Vendi tretë (III)
1	Tarik Ajvazi	Klasa 11	College "Mehmet Akif"	Vendi parë (I)
2	Vis Gashi		Gjimnazi "Gjon Buzuku"	Vendi dytë (II)
3	Malsor Arifi		College "Mehmet Akif"	Vendi tretë (III)
1	Skender Krasniqi	Klasa 12	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	Vendi parë (I)
2	Lindrit Berisha		Gjimnazi "Gjon Buzuku"	Vendi dytë (II)
3	Elona Shalaj		IAAP "Ymer Prizreni"	Vendi tretë (III)

V. Regjistrimi i nxënësve në klasë të dhjetë (10) për vitin shkollor 2023/2024

Duke u bazuar në kërkesën me nr. 3/2176 të datës 17.05.2023 të Departamentit të Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t, dhe takimit më datë 19.05.2023 me drejtorë të shkollave të mesme të larta, është bërë planifikimi i drejtimeve, profileve, paraleleve dhe numrit të nxënësve për regjistrim të nxënësve në klasë të dhjetë për vitin shkollor 2023/2024, në pesë (5) shkollat e mesme të larta që i menaxhon DKA në Prizren. Me drejtorët e shkollave të mesme të larta është diskutuar për planifikimet e shkollave sipas vendimit të MASHTI-t, duke mos cënuar kuadrin e shkollës dhe duke marrë parasysh numrin e nxënësve në rënie nga klasa e nëntë (9).

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013, Njoftimit Nr. 3/2176 të datës 17.05.2023 të Departamentit të Arsimit Parauniversitar për kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasë e (10) në gjimnaze dhe IAAP, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren pas mbajtjes së Testit të Arritshmërisë me nxënës të klasëve të IX-ta (me 4 dhe 11 korrik 2023) dhe marrjes së rezultateve nga MASHTI, do të shpallë konkurs për regjistrim të nxënësve në klasë të dhjetë (X) për vitin shkollor 2023/2024.

Gjithsej, numri i nxënësve të planifikuar për regjistrim në klasë të dhjetë (10) në pesë shkollat e mesme të larta është 1487 nxënës, nga të cilët 1239 shqiptarë, 164 boshnjakë dhe 84 turq.

3	SHMLPM "Luciano Motroni"	1	Shëndetësi	Bashkëpunator profesional i infermierisë	9	22	198	Shqiptar	Qender
		2	Shëndetësi	Teknikë i farmacistë	1	22	22	Shqiptar	Qender
		3	Shëndetësi	Infermier i pediatriisë	1	22	22	Shqiptar	Qender
		4	Shëndetësi	Teknikë dentar	1	22	22	Shqiptar	Qender
		5	Shëndetësi	Laborante mjekësor	1	22	22	Shqiptar	Qender
		6	Shëndetësi	Bashkëpunator profesional i infermierisë	1	22	22	Gjuhe Boshnjake	Qender
		7	Shëndetësi	Teknik Dentar	1	22	22	Gjuhe Boshnjake	Qender
		8	Shëndetësi	Bashkëpunator profesional i infermierisë	1	22	22	Gjuhe turke	Qender
		9	Shëndetësi						
4	SHMLPE "Ymer Prizreni"	1	Ekonomi	Kontabilitet dhe Tatime	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		2	Ekonomi	Banka Financa dhe sigurime	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		3	Administrim Biznesi	Asistent financiar	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		4	Administrim Biznesi	Marketing dhe shitje	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		5	Ekonomi	Shpedicion dhe logjistikë	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		6	Ekonomi	Teknik i informatikes se biznes	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		7	Ekonomi	Tregti me pakicë e shumicë	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		8	Hotelen	Kuzhinjer	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		9	Hotelen	Asistent i mikpritjes hotehere	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		10	Teknologji Ushqimore	Teknologji ushqimore	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		11	Bujqësi	Agrobiznes	1	18	18	Shqiptar	Prizren
		12	Juridik	Administrar dhe shërbime të zyrës	2	18	36	Shqiptar	Prizren
		13	Kontabilitet	Administrar dhe shërbime të zyrës	1	18	18	Turk	Prizren
		14	Kontabilitet	Kontabilitet dhe Tatime	1	18	18	Shqiptar	Romoj
		15	Kontabilitet	Kontabilitet dhe Tatime	1	18	18	Shqiptar	Gjonaj
		16	Ekonomi	Kontabilitet dhe Tatime	1	18	18	Boshnjak	Prizren
		17	Juridik	Administrar dhe shërbime të zyrës	1	18	18	Boshnjak	Prizren
		18	Hotelen	Kuzhinjer	1	18	18	Boshnjak	Reçan
5	SHMM "Lorenc Antoni"	1	Drejtimi i përgjithshëm	Bashkëpunëtorë muzikorë	2	15	30	Shqiptar	Qender
		2	Instrumental	Piano, Harqe, Frymorë, Balet, Solokëndim	1	15	15	Shqiptar	Qender
GJITHSEJ					72		1487		
GJITHSEJ PLANIFIKIMI NE 5 SHKOLLA SIPAS KOMUNITETEVE					Shqiptarë	Boshnjak	Turk		
					1239	164	84		

VI. Aktivitet: 7 Marsi – Dita e Mësuesit

Me komisionin e DKA-së është bërë përgatitja e listave të mësimdhënësve pensionistë për vitin 2022-2023 dhe shpërndarja e shpërblimeve me mirënjohje për mësimdhënësit pensionistë dhe nxënësve fitues në garat komunale, si në garat e Olimpiadës së Matematikës dhe të Fizikanit të Ri. Janë bërë përgatitjet e programit festiv me rastin e festës së 7 Marsit- Ditës së Mësuesit, ku me nxënësit e SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, është bërë përgatitja dhe është mbajtur program festiv me nxënës të shkollave në amfiteatrin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

VII. Aktivitet: Edukimi për Siguri me nxënës të klasave të XI-ta

Duke u bazuar në kërkesën e MASHTI-t me nr. 3/2178 të datës 16.05.2023 të MASHTI-t lidhur me organizimin e programit trajnues në fushën e sigurisë “Edukimi për Siguri” me nxënës të klasëve të 11-ta, nga DKA është kërkuar që së bashku me shkollat e mesme të larta të përzgjidhen 150 nxënës të klasëve XI-ta nga gjimnazet dhe shkollat profesionale të komunës sonë, që do të marrin pjesë në këtë trajnim: dy javë teori dhe një javë praktikë në kampet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) që filloi nga data 26 qershor 2023, në Gjimnazin “Remzi Ademaj” në Prizren.

Numri i nxënësve pjesëmarrës të klasave të 11-ta sipas shkollave:

Nr.	Shkolla	Numri i nxënësve sipas shkollave
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	30 nx. të të gjitha komuniteteve
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	30 nx. të të gjitha komuniteteve
3	SHMM "Luciano Motroni"	30 nx. të të gjitha komuniteteve
4	SHME "Ymer Prizreni"	15 nx. të të gjitha komuniteteve
6	Qendra e Kompetencës	15 nx. të të gjitha komuniteteve
7	SHMT "11 Marsi"	30 nx. të të gjitha komuniteteve
	Gjithsej	NXENES TE KLASAVE TE 11-ta

VIII. Aktivitet: Projekti YENI – Ndikimi i Rinisë në Mjedis (Eko-klubet) me shkollat e mesme të larta

- Duke zbatuar marrëveshjen e përbashkët ndërmjet DKA-së dhe Caritasit Zvicëran, për projektin **“Ndikimi i Rinisë në Mjedis”- YENI i Caritasit Zvicëran**, është bërë planifikimi që të fillojnë trajnimet e Eko-klubeve të 5 shkollave të mesme të larta.
- Trajnimi **dy (2) ditor** *“Zhvillimi i shkathtësive të të rinjve mbi mjedisin - 4 module”* për nxënësit/anetarët e **tri (3) Eko-klubeve** të shkollave të mesme të larta të Komunës së Prizrenit, (dy gjimnazet me shkollën e mesme të muzikës) dhe dy shkollat profesionale në komunën tonë “Luciano Motroni” dhe “Ymer Prizreni”, u mbajt me Eko-klubet e formuara nga shkollat e mesme të larta lidhur me projektin YENI.
- Trajnimet janë mbajtur më datë 09 - 10 shkurt 2023 dhe 23 - 24 shkurt 2023 në ambientet e gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren për grupin e parë dhe në SHMLM “Luciano Motroni në Prizren grupi i dytë.
- Trajnimet janë mbajtur me profesorë të lëndëve të biologjisë, ekologjisë dhe edukimit mjedisor në fushën e ndryshimeve klimatike e Eko-klubet me nxënës të shkollave të mesme të larta.
- Trajnimet me Eko-klubet e shkollave të dy gjimnazeve dhe shkollës së muzikës janë mbajtur më datë 09 dhe 10 shkurt 2023 në ambientet e gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren.
- Me përfaqësues të shkollave, mësimitdhënës të biologjisë, dhe koordinatore të shkollave për Eko - klubet është mbajtur trajnim dy ditor në Tiranë më datë 11-12 mars 2023, lidhur me edukimin mjedisor në fushën e ndryshimeve klimatike.
- Janë mbajtur trajnime në Prishtinë e Prizren me mësimitdhënës dhe nxënës të Eko-klubeve nga pesë (5) shkollat e mesme të larta nën menaxhimin e DKA-së. Trajnimet e modulit të dytë dhe tretë janë mbajtur me temë *“Mjetet mësimore rreth ndryshimeve klimatike”, etj.*

IX. MATURA SHETËRORE 2023

Duke u bazuar në vendimin e MASHTI nr. 01B/1768 të datës 20.03.2023 Provimi i Maturës Shtetërore 2023 u realizua:

- Afati i parë i provimit të maturës shtetërore u mbajt më datë 24 qershor 2023;
- Afati i dytë i provimit të maturës shtetërore u mbajt më datë 26 gusht 2023;

MATURA SHETËRORE 2023 – Afati qershorit

Në bazë të Ligjit mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018, UA 04/2016 dhe UA 05/2016 Detyrat dhe përgjegjësit e administrueseve dhe komisioneve të qendrave të testimit, Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me nr. 01B-032 të datës 20.03.2023, kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative për mbajtjen e Maturës Shtetërore 2023, që u organizua dhe u mbajt në afatin e parë më 24 qershor 2023 edhe në Prizren.

Sipas udhëzimeve të DVSM në MASHTI, nga shkollat e mesme të larta të komunës së Prizrenit janë marrë të gjitha listat e maturantëve dhe janë caktuar 16 Qendra të Testimit në Komunën e Prizrenit. Testit i janë nënshtruar 2181 maturantë nga të cilët 1923 maturantë të komunitetit shqiptar, 172 maturantë të komunitetit boshnjak dhe 120 maturantë të komunitetit turk. Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër Qendrat e Testimit dhe 76 administruesit e Provimit të Maturës Shtetërore nga shkollat e komunës sonë kanë administruar Testin e Maturës Shtetërore në komunat e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.

Në të gjitha qendrat e Testimit në Komunën e Prizrenit përgatitjet janë bërë në kohë dhe procesi ka vijuar në nivelin e duhur, si për sa i përket masave të sigurisë në ambiente, njësoj dhe administrimin e testit. Shkollat jgithashtu janë furnizuar me ujë të pijshëm. Ka ekzistuar klimë e mirë dhe ambiente motivuese brenda klasave. I është bërë kërkesë Policisë së Kosovës për secilën qendër të testimit, një ekip lëvizës ka qënë në shërbim sipas nevojave dhe logjistikës së komunës për përkrahje me auto mjete për komisionet e MASHTI-t dhe DKA-së. Në të gjitha qendrat e testimit përveç komisioneve nga MASHTI, DKA dhe Shkolla sipas ligjit të Maturës Shtetërore, ka pasur dhe monitorues e mbikëqyrës nga MASHTI, si dhe disa vëzhgues nga OJQ.

Në Qendrën nr. 1 në gjimnazin “Gon Buzuku” anëtari i komisionit të MASHTI-t Bardh Dervishi ka qënë për herë të parë pjesëmarrës në një testim në Maturë Shtetërore. Sipas raportimeve sjellja e tij ndaj dy anëtarëve të komisionit të DKA bazuar në ligjin për maturën shtetërore, nuk ka qënë e duhura pasi ka munguar bashkëpunimi i duhur dhe ka pasur sjellje jo të mirë. Në qendrën nr. 7 në “Luciano Motroni” mbi 70 teste me lëndën zgjedhore Biologji sipas listave të nxënësve kanë munguar, dhe komisionet i kanë pranuar ato teste nga shoferi i MASHTI-t, nxënësve iu është rekomanduar që të fillojnë në tri lëndë me kohë zgjidhjet deri sa kanë mbërritur testet për këta nxënës pas orës 11:00. Në disa teste ka pasur gabime teknike në printim.

MATURA SHETËRORE 2023 – Afati gusht 2023

Në bazë të ligjit mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018, UA 04/2016 dhe UA 05/2016, detyrat dhe përgjegjësitë e administruesëve dhe komisioneve të qendrave të testimit, vendimit të ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me nr. 01B-032 të datës 20.03.2023, kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative për mbajtjen e Maturës Shtetërore 2023, që u organizua dhe u mbajt në afatin e dytë më 26 gusht 2023 edhe në Prizren.

Sipas udhëzimeve të DVSM në MASHTI, nga shkollat e mesme të larta të komunës së Prizrenit janë marrë të gjitha listat e maturantëve dhe janë caktuar 6 Qendra të Testimit në Komunën e Prizrenit. Testit i janë nënshtruar 538 maturantë nga të cilët 480 maturantë të komunitetit shqiptar, 29 maturantë të komunitetit boshnjak dhe 29 maturantë të komunitetit turk. Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër Qendrat e Testimit dhe 36 administruesit e Provimit të Maturës Shtetërore nga shkollat e komunës sonë kanë administruar Provimin e Maturës Shtetërore në komunat e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.

Në të gjitha qendrat e testimit në Komunën e Prizrenit përgatitjet janë bërë me kohë dhe procesi ka shkuar në nivel shumë të mirë si në ambientet e sigurisë dhe administrimin e testit. Janë furnizuar shkollat me ujë të pijshëm. Ka ekzistuar klimë e mirë dhe ambiente motivuese brenda klasave. I është bërë kërkesë Policisë së Kosovës për secilën qendër të testimit dhe një ekip lëvizës ka qenë në shërbim sipas nevojave. Përveç komisioneve nga MASHTI, DKA dhe Shkollave sipas ligjit të Maturës Shtetërore, kishte monitorues dhe mbikëqyrës nga MASHTI, si dhe vëzhgues tjerë.

X. Aktivitet: 22 Maji - Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit

Duke u bazuar në kërkesën e MASHTI-t dhe Procesverbalin nr. I/2023 KO-tiv, për shënimin e 22 Majit "Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit", bazuar në vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI-së) së bashku me MASHTI-n, DKA dhe universitetet publike të Republikës së Kosovës, është mbajtur aktivitet me nxënës, mësimmshënës dhe studentë të universiteteve publike, duke shënuar 22 Majin - Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit.

Është mbajtur tryezë bisedimi dhe punëtori – Nga Marrëveshja në Veprim: Rindërtoni Biodiversitetin, me prezantime nga: MMPHI, studentë të Universitetit të Prishtinës dhe Prizrenit, nxënës e mësimmshënës nga IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren dhe punëtori me nxënës të SHFMU "Mushnikova" në Mushnikovë.

XI. Aktivitet: Panairi me Universite/Kolegje Amerikane - EdUSA University Fair

Bazuar në kërkesën e kryetarit të Komunës së Prizrenit z. Shaqir Totaj për marrje pjesë në panairin e universiteteve dhe kolegjeve amerikane të organizuar nga ambasada amerikane - EdUSA University Fair - Kosovo.

Me nxënës të shkollave të mesme të larta kemi marrë pjesë në këtë panair, ku rreth 55 nxënësit e dalluar nga shkollat e mesme të larta, kanë parë nga afër mundësitë e studimeve në Amerikë. Ky panair ka ofruar informacione të vlefshme mbi programet e studimit, mundësi të bursave dhe ndihmës financiare, si dhe mundësinë e komunikimit me përfaqësues të universiteteve nga SHBA- të.

XII. Punëtori lidhur me Planin Zhvillimor të Arsimit në Komunë - PZHKA 2024 – 2027

Plani për Zhvillimin e Arsimit në Komunën e Prizrenit 2024-2027 do të hartohet me ekipin sipas vendimit të DKA-së bazuar në dokumente të rëndësishme legjislative dhe strategjike në nivel qendror, si: Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji për Arsimin në Komuna, Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2022-2026, Strategjisë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, Strategjisë për përfshirjen e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare, etj. Plani ka për qëllim që të përcaktohen kahet e zhvillimit të sistemit të arsimit parauniversitar në Komunën e Prizrenit gjatë periudhës 2024-2027, të cilat do të bashkërendisin politikat arsimore të nivelit qendror me prioritetet zhvillimore të këtij sektori të përcaktuara në nivelin komunal. Për të siguruar harmonizimin e këtij plani me politikat qendrore dhe të interesave komunale, hartimi i planit do të bëhet përmes një procesi me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha strukturave me interes në sferën e arsimit. Ekipi komunal, nga data 1 – 3 dhjetor 2023, ka filluar të punojë draftin e parë. Ekipi përbëhet nga Zyrtarë të DKA-së dhe MASHTI-t, përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetit të prindërve.

VIV. Zbatimi në praktikë i Kurrikulës së Re dhe vlerësimi i kompetencave

Duke u bazuar në kërkesat e shkollave për trajnimin e mësimeve të rinj për zbatimin në praktikë të kurrikulës, në bashkëpunim me DZHPM në MASHTI dhe me ekipin e trajnerëve të Kurrikulës, janë duke grumbulluar listat e mësimeve të rinj nga shkollat, të cilët janë në proces e sipër nga procedurat e konkursit, kemi planifikuar që të fillojmë trajnimin sipas grupeve dhe fushave të KK- së.

Trajnimet janë mbajtur gjatë muajit mars dhe prill 2023 me të gjithë mësimeve të rinj nga konkurset e fundit të organizuar në komunën e Prizrenit.

Takime me Ekipin e trajnerëve të Komunës së Prizrenit sipas vendimit të DKA me nr. 301/22 të datës 03.02.2022, janë mbajtur trajnimet gjashtë (6) ditore dhe është diskutuar lidhur me zbatimin e kurrikulës së re në shkollat e komunës si dhe marrjen e të dhënave për vlerësimin e formulimin e një pyetësi online për marrjen e informatave nga shkollat në kuadër të caktimit të nevojave të shkollave për përgatitjet e vlerësimit të kompetencave – vlerësimi për shkallë kurrikulare në nivel komune.

Nga të dhënat e marra prej shkollave, është shënuar një raport në DKA me nr. 526/23 të datës 21.03.2023. Gjithashtu, pas mbajtjes së trajnimeve të reja në vitin 2023 dhe vlerësimit të portofoleve të mësimeve të rinj, është nxjerrë raport me nr. 2244/23 të datës 23.11.2023 për DKA lidhur me implementimin e kurrikulës në të gjitha shkollat e komunës së Prizrenit të cilat janë nën menaxhimin e DKA-së.

XV. Flutura Academy

Në bashkëpunim me agjencinë Flutura është punuar me shkathtësimin e nxënësve dhe të rinjve për përdorimin e teknologjisë informative, në zhvillimin e aplikacioneve digjitale dhe ... Akademisë i është dhënë në shfrytëzim një pjesë e ShFMU "Lidhja e Prizrenit", të cilën Akademia e ka pajisur me mjete të teknologjisë digjitale të cilat do të jenë në shfrytëzim të komunitetit arsimor.

XVI. Mësimi për të rritur

Drejtorja e Arsimit ka nisur me projektin e arsimit për të rritur, gjegjësisht arsimin joformal. Shumë qytetarë, të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të përfundojnë arsimin e detyrueshëm, kanë shprehur interesimin që të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, si e drejtë themelore e tyre. Për këtë arsye DKA ka nisur me procesin e përfshirjes së qytetarëve të interesuar në këtë projekt. Grupi i parë është i përbërë prej 60 qytetarëve.

XVII. Your Job / Puna juaj

Së bashku me partnerin Caritas Kosova e gjithë mosha rinore do të përfitojë nga programet që ofron Caritasi i Kosovës lidhur me orientimin në karrierë dhe ndërtimin e shkathtësive të buta. Drejtorja e arsimit ka ofruar të gjitha parakushtet në mënyrë që të përfitojë një numër sa më i madh i të rinjve nga shkollat tona.

XVIII. Digjitalizimi i shërbimeve arsimore

Me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të institucioneve arsimore në aspektin e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit, drejtorja e arsimit ka nisur procesin e digjitalizimit të shërbimeve arsimore. Është angazhuar kompania konsulente e cila përmes punëtorive me të gjithë komunitetin

arsimor ka hartuar termat e referencës për të zhvilluar sistemin softuer me të cilin digjitalizohet në tërësi sistemi i arsimit.

XIX. Përkrahja e mësimdhënësve klasorë

Për ta mbështetur punën e mësimdhënësve, janë angazhuar pesë psikologë profesionistë, të kualifikuar edhe si mësimdhënës, për të mbështetur mësimdhënësit klasorë të përballojnë sfidat në punë me nxënësit në nevojë dhe ata me nevoja të veçanta, përfshirë nxënësit e komuniteteve pakicë që kanë vështirësi në të nxënë.

XX. Asistenca për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

Përmes programit të Caritas Kosova për të përkrahur nxënësit në nevojë dhe ata me nevoja të veçanta arsimore, Drejtoria e Arsimit ka angazhuar 8 psikologë shtesë të cilët do të shpërndahen në shkollat e komunës për të ofruar shërbimet themelore psikologjike për fëmijët dhe personelin arsimor.

XXI. Një robot për çdo fëmijë

Në bashkëpunim me Kosova Markers League, 43 shkolla fillore kanë përfituar pajisje dhe kurse/trajnime për zhvillimin e robotikës dhe koncepteve digjitale. Për t'iu përgjigjur nevojave të kohës, mësimdhënësit dhe nxënësit do të aplikojnë së bashku pajisjet digjitale / robotët në funksion të rritjes së cilësisë.

XXII. Rritja e sigurisë në shkolla

Përmes KFOR-it italian, një grup profesorësh të biologjisë janë trajnuar të japin ndihmën e parë përmes pajisjeve të veçanta të revitalizimit apo rikthimit në jetë të personave të cilët për shkaqe të ndryshme gjenden në situatë krrike për jetën. KFOR-i italian ka dhuruar pesë komplete të

defrbrilatorëve për shkollat e mesme të larta.


Trajnimi i mësimdhënësve dhe vlerësimi i portofoleve të tyre

Numri i mësimdhënësve të cilët kanë kryer trajnimin e KKK-së sipas viteteve shkollore:

Nr	Fusha e Kurrikulës	Viti 2017/18	Viti 2018/ 19	Viti 2019/20	Viti 2021/22	Viti 2022/23	Viti 2023/24	Gjithsej
1	Gjuhët dhe Komunikimi	225	71	33	29	25	12	395
2	Programi fillor dhe klasa përgatitore	238	169	129	119	106	49	810
3	Shkencat e Natyrës	143	26	10	5	7	3	194
4	Shoqëria dhe Mjedis	140	22	10	8	12	9	201
5	Artet	54	11	4	6	6	1	82
6	Matematika	91	20	5	5	9	0	130
7	Jeta dhe Puna	48	5	5	3	5	3	69
8	Edukata fizike, shëndeti dhe sportet	49	8	2	6	5	1	71

Gjithsej	988	332	198	181	175	78	1952
----------	-----	-----	-----	-----	-----	----	------

Numri i mësimeve sipas fushave të KK-së



DKA ka nxjerrë vendim me nr. 301/22 të datës 03.02.2022 të plotësuar me vendimin me nr. 1636/23 të datës 05.09.2023 për themelimin e ekipit të trajnerëve për zbatimin në praktikë të kurrikulës së re në arsimin parauniversitar në Komunën e Prizrenit.


III. Infrastruktura në institucionet arsimore


Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punime me realizimin e projekteve dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve të shkollave, si dhe ka monitoruar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore si dhe rinovimin e tyre. Janë realizuar aktivitete të ndryshme si vijon:

1. Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjane" në Pllanjanë

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 151.896.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 151.896.00€ / 100% realizim)

Punimet janë duke vazhduar dhe planifikohet të përfundojnë në tremujorin e parë të vitit 2024.





2. Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjetër Mazrreku) në Mazrrek

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 100.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 100.000.00 euro / 100% realizim)

Punimet janë duke vazhduar me shtyllat e përdhësës. Deri më tani janë realizuar kryesisht punimet e vrazhda të bodrumit. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2025.



3. Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushë të Vogël

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 200.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 200.000.00 euro / 100% realizim)

Punimet janë duke vazhduar. Punimet pritet të përfundojnë gjatë vitit 2024, ku më pas do të shpallet për ofertë edhe faza e dytë e punimeve.

Përfundimisht objekti do të jetë në funksionim gjatë vitit 2025.





4. Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasë) në Gjonaj të Hasit

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 156.709.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 156.709.00€ / 100% realizim)

Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

Pjesa e mbetur për pagesë prej 24.779.20 euro është e planifikuar të realizohet gjatë vitit 2024.





5. Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor "Ardhmëria" në Landovicë

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 220.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 220.000.00 euro / 100% realizim)

Të gjitha punimet janë realizuar dhe gjatë muajit dhjetor do të bëhet edhe pranimi teknik.


Pjesa e mbetur për pagesë prej 240.218.89 euro është e planifikuar të realizohet gjatë vitit 2024.



6. Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vermice

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 100.000.00 euro. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 100.000.00 euro / 100% realizim)

Deri më tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, trarë, mure dhe pllaka në dy nivele, bodrum dhe përdhesë dhe për momentin punimet janë ndërprerë në mungesë të mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në fund të vitit 2024.




7. Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Haziz Tola" në Lagjen 'Jeta e Re' - Prizren - faza e dytë

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 80.000.00 euro. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 80.000.00 euro / 100% realizim)

Punimet janë duke u realizuar sipas planifikimit, kryesisht punime në suvatim dhe patinim të mureve, punim të dyshemeve me pllaka, etj.


Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2024



8. Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Fatmir Berisha" në Lagjen 'Bajram Curri' - Prizren - faza e dytë

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 80.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 80.000.00 euro / 100% realizim)

Punimet janë duke u realizuar sipas planifikimit, kryesisht punime në suvatim dhe patinim të mureve, punim të dysHEMEVE me pllaka, izolime, etj. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2024.



9. Ndërrimi i dyerve dhe dritareve të shkollës "Fatmir Berisha" Prizren


(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 80.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 58.610.00 euro / 100% realizim. Vlera e kontratës 58,610.00 euro)

Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

10. Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë – Has

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 50.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 50.000.00 euro / 100% realizim)

Deri më tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, trarë, mure, pllaka dhe kulmi) të etazhës së dytë dhe për momentin punimet janë ndërprerë në mungesë të mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në fund të vitit 2024.



11. Rinovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Gernqare" Novoselan

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 50.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 50.000.00 euro / 100% realizim)


Deri më tani janë realizuar punimet e shembjes dhe të rinovimit të objektit ekzistues. Janë realizuar punimet e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, ngrohjes qendrore, pastaj është ndërruar kulmi në tërësi, si dhe punime tjera si suvatime, etj. Për momentin po punohet me intensitet më të ulët për arsye të mungesës së mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në fund të vitit 2024.



12. Ndërrimi i kaldajave të ngrohjes qendrore në: SHFMU "Mustafa Bakia" Prizren, SHFMU "Nazim Buduri" Hoqë e Qytetit dhe SHFMU "25 Maj" Lubinjë e Poshtme

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 100.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 99.998.15€ / 99.99% realizim)


Në shkollat e lartpërmendura janë montuar kaldajat e reja dhe janë në funksion. Për shkak të mungesës së buxhetit, kanë mbetur edhe disa gjëra të parealizuara, por që nuk ndikojnë në funksionimin e ngrohjeve qendrore nëpër këto shkolla. Punimet pritet të përfundojnë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024.



13. Rregullimi i ambientit të oborreve në shkollat e Prizrenit

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 178.900.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 178.900.00 euro / 100% realizim)



Janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat “Zenun Çoçaj” në Gjonaj dhe “Dëshmoret e Kabashit” në Korishë. Punimet do të vazhdojnë gjatë vitit 2024 në shkollën “Gani Saramati” kur pritet të përfundojë edhe kontrata.



14. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" Lutogllavë

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 50.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 50.000.00 euro / 100% realizim)

Deri tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, trare, mure dhe pllaka) të aneksit të përdhësës dhe për momentin punimet janë ndërprerë në mungesë të mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026.



15. Rinovimi i tërësishem i objektit shkollor (aneksit të vjetër) "Naim Frashëri" Vlashnje


(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 50.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 50.000.00 euro / 100% realizim)

Ka mbetur të realizohet edhe rinovimi i dysHEMEVE, punime këto që nuk ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Janë realizuar punime të ndryshme si SUVATIME, PATINIM I MUREVE, LYERJE E MUREVE DHE PLAFONEVE, NDËRRIMI I KULMIT, ETJ. Për shkak të mungesës së buxhetit, pozicioni i dyshemesë pritet të përfundojnë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024.

16. Rinovimi i objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren

(Mietet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 90.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 90.000.00 euro / 100% realizim)

Punimet janë duke u realizuar sipas planifikimit, kryesisht punime në suvatim dhe patinim të mureve, rrjet elektrik, rrjet të ngrohjes qendrore për sallën e edukatës fizike, punim të dyshemeve dhe mureve të nyjeve sanitare me pllaka qeramike, izolime, etj. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2024



17. Rinovimi i sallës së edukatës fizike të SHFMU "Mustafa Bakia"

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 30.000.00 euro. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 18.900.00 euro / 100% realizim)

Punimet janë realizuar.

18. Ndërtimi i çerdhes në lagjen 'Tusus' Prizren

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 150.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 150.000.00 euro / 100% realizim)

Deri më tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, trare, mure dhe pllaka) të bodrumit dhe pse përballë mungesës së mjeteve financiare punimet jane duke vazhduar. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026.



19. Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Lagjen "Bajram Curri" Prizren


(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 130.000.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 0.00€ / 0% realizim. Mjetet nga ky projekt, me vendim të Asamblesë Komunale, janë transferuar në projektin "Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjetër Mazrreku) në Mazrek, ku projekti do të realizohet 100%)

Për arsye të mungesës së parcelës, ky projekt është anuluar.

20. Rinovimi i objektit shkollor SHFMU "Brigada 125" ne Medvec

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 39.495.00 euro. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 37.001.15 euro / 93.68%)

Punimet janë realizuar.



Gjatë vitit 2023, në kuadër të investimeve kapitale, kanë qenë të planifikuara 20 projekte, në vlerë prej 2.087.00.00 euro

Nga këto projekte vetëm 1 projekt (ndërtimi i objektit të ri shkollor ne Lagjen "Bajram Curri" Prizren) nuk është realizuar. Mjetet financiare të planifikuara për këtë projekt kanë qenë në vlerë prej 130.000.00 euro dhe janë ridestinuuar për projektin, "Ndërtimi i objektit të ri shkollor 'Gjergj Kastrioti Skenderbeu' (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek".

Sipas rrjedhës së punimeve, gjegjësisht realizimit të tyre, deri me datë 26.12.2023, janë realizuar 98.18% apo 2.049.014.11 euro

Gjatë vitit 2023 janë realizuar edhe 3 projekte tjera (nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime) si më poshtë:

1. Rinovimi i tërësishëm i sallës së edukatës fizike, të shkollës "Emin Duraku" në Prizren, në vlerë prej 61.078.00 euro.

Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

2. Rinovimi i kulmit të objektit shkollor SHFMU "Dëshmoret e Hasit" në Fshatin Kabash dhe rinovimi i kulmit të objektit shkollor SHFMU "Nefit Jusufi" në Fshatin Skorobisht, në vlerë prej 39.901.20 euro.

3. Punimi i hapësirave për kabinete, në nënkulmin e shkollës "Sinan Thaqi" në Fshatin Zojz, në vlerë prej 94.431.57 euro.

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "KOSOVA * KOSOVA" at the top, "PRIZREN" in the center, and "SHKOLLOR" at the bottom. The signature is a cursive script that extends to the right of the stamp.